

MARS 2023 | Nr. 25

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN





SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Komunikimi me qytetarët është pjesë e punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për këtë arsye, pjesë e ndryshimeve në strukturën organizative të zyrës së ILD-së, për ta bërë sa më funksional institucionin, është edhe plotësimi i sektorit të ankesave me dimensionin e marrëdhënieve me publikun.

“Sektori i ankesave dhe marrëdhënieve me publikun” është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut.

Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e an-

kesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Pjesë e këtij sektori është edhe **Koordinatori për të drejtën e informimit**.





Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas

komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Gjatë muajit **Mars 2023**, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka pritur **14 ankues**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe **19 telefonata me qytetarë**, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.

Gjatë depozitimit të një ankese



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuesin për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit Mars 2023, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur 21 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuesit t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë

në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevoje, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.

MARS I NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Mars** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **64** ankesa, **60** nga qytetarët dhe **4** e paraqitur nga institucion.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Mars** 2023. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

VERIFIKIME

18 vendime verifikimi, nga të cilat:

8 vendime verifikimi (Praktika të ILD-së);

10 vendime verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD);

HETIME DISIPLINORE

2 vendime hetimi disiplinor për 2 magjistratë

1 vendim për mbyllje hetimi disiplinor për 2 magjistratë

2 kërkesa përprocedim disiplinor për një magjistrat

ARKIVIME

- 109 vendime arkivimi nga 229 praktika të shqyrtuara:

30 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (ILD);

41 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (dosje të mbartura nga ish KLD);


- 38 vendime arkivimi pas verifikimit, nga të cilat :

6 vendime arkivimi pas verifikimit (ILD);

32 vendime arkivimi pas verifikimit (dosje të mbartura nga ish KLD).

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit Mars Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **30** ankues, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në standat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në standat e bashkive nga vijnë ankuesit. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në total ka bërë ka bërë 262 shpallje publike.

**INFORMACION**

Për shkak të rikonstruksionit të godinës, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvendoset për një periudhë kohore në adresën Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, kati 3, Tiranë (tek Avokatura e Shtetit). Oraret për komunikimin me qytetarët që duan informacion apo të paraqesin ankesë pranë ILD-së mbeten të pandryshuara. Ekipi i Zyrës së ankesave do i mirëpresë cdo ditë pune nga ora 09.00 – 14.00.

Pritja e qytetarëve do të kryhet në katin e parë të institucionit.



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NIS BASHKËPUNIMIN DYPALËSH ME SHËRBIMIN SPANJOLL TË INSPEKTIMIT

Madrid 7 Mars 2023

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një vizitë pune në Madrid me ftesë të znj. Amparo Camazón, shefe e Shërbimit të Inspektimit pranë Këshillit të Përgjithshëm Gjyqësor të Spanjës.

Në takimin e zhvilluar në ambientet e Shërbimit të Inspektimit spanjoll, drejtuesja znj. Amparo Camazón dhe zv. drejtuesja Elena Burgos e njohën delegacionin shqiptar me organizimin, financimin, funksionet, detyrat dhe shërbimet e tjera kombëtare përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin

e sistemit të drejtësisë në Spanjë, përfshi natyrën e tipologjinë e misioneve, teknologjitë e informacionit e komunikimit, transparencën e komunikimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe marrëdhëniet me jashtë të Shërbimit të Inspektimit spanjoll.

Në ditën e dytë, anëtarë të shërbimit të inspektimit spanjoll bënë disa prezantime mbi sistemin disiplinor në Spanjë, legjislacionin përkatës, nisjen e një veprimi disiplinor, rastet disiplinore, procedura disiplinore dhe njësia e shërbimeve për qytetarët.



Ky bashkëpunim dypalësh me homologët spanjollë është pjesë e bashkëveprimit në kuadër pjesëmarrjes së përbashkët të ILD-së, në Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Inspektimit.

Shkëmbimi i eksperiencës dhe njohja me praktikat e institucioneve homologe ndërkombëtare është pjesë e vizionit të ILD-së, për të zbatuar standardet më të mira të

punës në procesin disiplinor.

Në përfundim të kësaj vizite pune, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me ftesë të Departamentit të së Drejtës Kushtetuese të Universitetit të Seviljes mori pjesë në një tryezë diskutimi mbi sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

Shkëmbimi i eksperiencës dhe njohja me praktikat e institucioneve homologe ndërkombëtare është pjesë e vizionit të ILD-së, për të zbatuar standardet më të mira të punës në procesin disiplinor.



LUFTA PËR PAVARËSINË E PUSHTETIT GJYQËSOR NUK ËSHTË DESTINACION FINAL POR NJË PËRPPJEKJE E PËRDITSHME

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në takim e organizuar nga Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian (KKIE) me temë “Çfarë pritet nga Shqipëria gjatë procesit të negociatave me Bashkimin Evropian?”, ku merrte pjesë Komisioneri për Fqinjësinë dhe Zgjerimin në Komisionin Europian z. Olivér Várhelyi dhe drejtues të institucioneve të pavarura e përfaqësues të shoqërisë civile në vend.

Duke e marrë fjalën në takim, z. Metani u ndal në përpjekjet për pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe të një mjedisi demokratik të shëndetshëm në vend.

“Lufta për pavarësinë e pushtetit gjyqësor nuk është një destinacion final, është një përpjekje e përditshme e të gjithëve ne, pra jo vetëm e strukturës që punon dhe lufton për ta ngritur e për ta bërë funksional sistemin e kontrollit kushtetues dhe demokratik të punës së gjyqtarëve e prokurorëve, por kërkohet më shumë se kaq, kërkohet edhe një mjedis demokratik, që sistemi gjyqësor dhe institucionet e drejtësisë të funksionojnë. Nuk mund të ketë padyshim demokraci pa pavarësi të pushtetit gjyqësor, por s’mund të ketë as pavarësi të sistemit gjyqësor pa demokraci dhe kultivimi i një mjedisi demokratik në një shoqëri si kjo, dhe

Lufta për pavarësinë e pushtetit gjyqësor nuk është një destinacion final, është një përpjekje e përditshme e të gjithëve ne, pra jo vetëm e strukturës që punon dhe lufton për ta ngritur e për ta bërë funksional sistemin e kontrollit kushtetues dhe demokratik të punës së gjyqtarëve e prokurorëve, por kërkohet më shumë se kaq, kërkohet edhe një mjedis demokratik, që sistemi gjyqësor dhe institucionet e drejtësisë të funksionojnë. Nuk mund të ketë padyshim demokraci pa pavarësi të pushtetit gjyqësor, por s'mund të ketë as pavarësi të sistemit gjyqësor pa demokraci .

të polarizuar nëse mund ta them, zgjidhja e në debatin e momentit, por duke i parë vetme afatgjatë mendoj unë është diskutimi dhe kërkimi i zgjidhjeve për çështjet që ngrihen në një moment të caktuar është ato vlera për të cilat ju diskutoni me diskutim jo emocional dhe jo duke u bazuar në pikëpamje të momentit, por duke i parë vetme afatgjatë, duke i parë zgjidhjet në mi dhe kërkimi i zgjidhjeve për çështjet që ngrihen në një moment të caktuar është ato vlera për të cilat ju diskutoni me diskutim jo emocional dhe jo duke u bazuar në pikëpamje të momentit, por duke i parë vetme afatgjatë”, tha z. Metani.



Fjala e plotë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

Faleminderit z. Balla!

Përshëndetje z. Várhelyi! Mirë se erdhët në Shqipëri.

E konsideroj kënaqësi të jem pjesë e kësaj tavoline, edhe pse mund të kem ndonjë dyshim nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë apo edhe institucionet e drejtësisë mund të jenë pjesë e proceseve apo tryezave si këto, por gjithsesi e konsideroj kënaqësi edhe personale, sepse të jesh pjesë e këtij procesi të rëndësishëm për të ardhmen e vendit është edhe kënaqësi profesionale, sepse je në një ambient ku shkëmben diskutime edhe mbi vlerat për të cilat ne po luftojmë. Shkëmbejmë mendime me kolegë apo struktura të Bashkimit Evropian, nga të cilat

ne padyshim presim edhe të shkëmbejmë mendime mbi vlerat mbi të cilat po ndërtohet kjo reformë apo edhe ecuria e Shqipërisë në këtë proces.

Së dyti, padyshim nuk është vendi për të folur për atë që është bërë mirë apo mund të ishte bërë më mirë nga strukturat tona, apo nga imja personalisht, por them që lufta kundër korrupsionit në gjyqësor, lufta për pavarësinë e pushtetit gjyqësor nuk është një destinacion final, është një përpjekje e përditshme e të gjithëve ne, pra jo vetëm e strukturës që punon dhe lufton për ta ngritur e për ta bërë funksional sistemin e kontrollit kushtetues dhe demokratik të punës së gjyqtarëve e prokurorëve, por kërkohet më shumë se kaq, kërkohet edhe një mjedis demokratik, që sistemi gjyqësor dhe institucionet e drejtësisë të funksionojnë. Nuk mund të ketë padyshim





demokraci pa pavarësi të pushtetit gjyqësor, por s'mund të ketë as pavarësi të

sistemit gjyqësor pa demokraci dhe kultivimi i një mjedisi demokratik në një shoqëri si kjo, dhe të polarizuar nëse mund ta them, zgjidhja e vetme afatgjatë mendoj unë është diskutimi dhe kërkimi i zgjidhjeve për çështjet që ngrihen në një moment të caktuar është diskutim jo emocional dhe jo duke u bazuar në debatin e momentit, por duke i parë zgjidhjet afatgjata, duke i parë zgjidhjet në përputhje me kushtetutën dhe pikërisht mbi ato vlera për të cilat ju diskutoni me Shqipërinë dhe strukturat e BE-së po nego-

Ju faleminderit!
Kjo është ajo që unë e konsideroj të rëndësishme për ta bërë reformën funksionale, përtej detyrimeve që ne kemi dhe duhet të marrim angazhim për të bërë edhe më shumë në këtë drejtim, por gjithsesi mendoj që përpjekjet e një institucioni apo qoftë edhe pesë institucioneve do ishin gjysmake, nëse nuk kuptohet rëndësia e kësaj reforme nga të gjithë, edhe nga pjesëmarrësit në tavolinë, por edhe nga të tjerë përtej saj.

“Zgjidhja e vetme afatgjatë mendoj unë është diskutimi dhe kërkimi i zgjidhjeve për çështjet që ngrihen në një moment të caktuar është diskutim jo emocional dhe jo duke u bazuar në debatin e momentit, por duke i parë zgjidhjet afatgjata, duke i parë zgjidhjet në përputhje me kushtetutën” tha z. Metani.



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË TAKIM ME AMBASADOREN E FRANCËS NË SHQIPËRI

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani vlerësoi mbështetjen e Francës në konsolidimin e demokracisë në vendin tonë, reformat e rëndësishme të ndërmarra, si shoqërohej nga zj. Elisabeth Barsacq, e cila ajo në drejtësi dhe rrugëtimin e Shqipërisë në procesin e antarësimit në Bashkimin Europian me negociatat e nisura me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut”.

Duke e falenderuar për vizitën, z. Metani

Z. Metani vlerësoi mbështetjen e Francës në konsolidimin e demokracisë në vendin tonë, reformat e rëndësishme të ndërmarra, si ajo në drejtësi dhe rrugëtimin e Shqipërisë në procesin e antarësimit në Bashkimin Europian.



Inspektori i Lartë i Drejtësisë e njohu ambasadorin me punën e ILD-së dhe me aktivitetin si anëtar vëzhgues në Rrjetin European të Shërbimeve të Inspektimit (RESIJ), që drejtohet nga Franca.

Duke folur për reformën në drejtësi, z. Metani dhe znj. Barsacq bashkëndanë mendimin se ky është një proces i gjatë që do kërkojë kohën e vet për të arritur rezultatet e pritshme nga vullneti gjithëpërfshirës për

një sistem drejtësie funksional e me standarde.

Nga ana tjetër, z. Metani evidentoi se përpjekjet për pavarësinë e magistratëve nuk duhet të shihen si destinacion final por si një përpjekje e përditshme e të gjitha institucioneve, sepse vetëm një sistem drejtësie funksional sjell rezultatet që priten.

Duke folur për reformën në drejtësi, z. Metani dhe znj. Barsacq bashkëndanë mendimin se ky është një proces i gjatë që do kërkojë kohën e vet për të arritur rezultatet e pritshme nga vullneti gjithëpërfshirës për një sistem drejtësie funksional e me standarde.

MARS 2023


Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
 Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
 Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko](#)